ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KOMUNA SHTIME**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **617-26-7715-2-2-1**

Sa i përket tenderit për **Mirëmbatja dhe riparimi i automjeteve për Institucionet e Komunës së Shtimës-Kontratë kornizë 24 muaj**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	**Gentian Sakaj B.I.**
NUI	**811044833**
Adresa	**Rruga "Skenderbeu" p.n.**
Vendi	**Suharekë**
Kodi postar	**23000**
Numri Telefonit	**+386 49547005**
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	**Gentian Sakaj**
Adresa elektronike	**gentiautoservis2016@gmail.com**
Data e parashtrimit të ankesës	**13.11.2026**

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit

Adresa e plotë

Numri i Telefonit

Numri i faks-it

Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Mirëmbatja dhe riparimi i automjeteve për Institucionet e Komunës së Shtimës-Kontratë kornizë 24 muaj

Titulli: Mirëmbatja dhe riparimi i automjeteve për Institucionet e Komunës së Shtimës-Kontratë kornizë 24 muaj

Nr i prokurimit 617-26-7715-2-2-1

Njoftimi për kontratë: 15.09.2026

Afati për dorëzimin e ofertave: 05.10.2026

Njoftim mbi vendimin e autoriteti kontraktues: 30.10.2026

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐ ***Jo*** ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ **Jo** ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontestit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

Kërkesë për rishqyrtim: 03.11.2026 13:21

Vendimi i AK në Kërkesën për rishqyrtim: 10.11.2026 09:33

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Ligji Nr. 04/L-042 PËR PROKURIMIN PUBLIK TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, I ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 (Versioni i Konsoliduar)
Neni 6 - Ekonomiciteti dhe Efikasiteti
Neni 7 - Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi
Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
Nenin 62 - Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit

RREGULLORE NR.002/2024 PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORES NR. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK (Versioni i Konsoliduar)
Neni 40 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
Neni 43 - Ndërprerja e procedurave të prokurimit

UDHËZUES Nr. 002/2024, PËR PLOTËSIM NDRYSHIMIN E UDHËZUESIT Nr. 001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK
10. Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Me date 05.10.2026 kemi dorëzuar ofertën për këtë aktivitet te prokurimit, komfor te gjitha kushteve dhe kritereve te dosjes se tenderit (DT) për tenderin me Titulli: Mirëmbatja dhe riparimi i automjeteve për Institucionet e Komunës së Shtimës-Kontratë kornizë 24 muaj, me numer prokurimi: 617-26-7715-2-2-1.
Me datë 30.10.2026 kemi pranuar Njoftim Mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues me Rezultatin e aktivitetit të prokurimit: Anulohet aktiviteti i prokurimit.

Pretendimi 1:
AK Komuna Shtime me datë 16.10.2026 ka shpërblyer me kontratë: N.T.SH. AUTO-BEKA, kllokot, 61050, kllokot, Kosovë; si dhe ne si OE tenderues kemi pranuar Letër standarde për tenderuesin e pasuksesshëm pasi që oferta e jonë nuk qe tenderi me çmimin më të ulët.

Me datë 21.10.2026 ne si OE kemi paraqit Kërkesë për rishqyrtim të vendimit ku na është Aprovuar kërkesa me datë 23.10.2026.
Vendimi i ri me datë 30.10.2026 për Anulim të procedurës, vjen pasi që ne si OE kemi ofertën e përgjegjshme më të lirë me çmim të renditur pasi që OE që ishte me çmim më të lirë është i papërgjegjshëm.
Me këtë veprim konstatojmë se AK me qëllim është duke tentuar që ta anuloj procedurën vetën sepse NUK ka mundur që ta shpërblej me kontratë OE si në vendimin paraprak të datës 16.10.2026. AK këtë "gabim" që quhet i tillë sipas vendimit të datës 30.10.2026, ka mundur ta korrigjoj që nga Njoftimi për Kontratë, Njoftim mbi korrigjimin, para Afati për dorëzimin e ofertave: 05.10.2026, ose përfundimisht AK këtë gabim ka mundur ta evidentoj para shpalljes për fituesin e tenderit.
Anulimi i procedurës në këtë fazë bëhet për arsyet jo sepse ka gabuar OE apo nuk ka operator ekonomik të përgjegjshëm por sipas AK sepse ka ndodh një shkelje e LPP-së, e cila nuk mund të korrigjohet apo parandalohet përmes një ndryshimi. Bazuar në këtë konstatojmë se Asnjë shkelje e LPP-së nuk ka ndodhur gjatë procedurës. Andaj pasi që çmimet e ofertës janë me çmime njësi, gabimi i specifikuar nga AK mund të kualifikohet si gabim teknik dhe si i tillë bazuar në paragrafin 45.19 të RREGULLORE NR.002/2024 PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORES NR. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK (Versioni i Konsoliduar), citoj: Neni 59.4 i LPP-së gjithashtu lejon autoritetin kontraktues që të pranojë ofertat, në raste të gabimeve ose paqartësive dhe në raste të devijimeve të vogla. Në të dyja rastet është një kusht që aspektet materiale të njoftimit për kontratë / dosjen e tenderit nuk janë prekur.

Neni 43 i Rregullores për prokurim publik ka specifikuar situatat kur AK munde te anuloje procedurën e prokurimin pas HAPJES se ofertave:
43.5 Procedura e prokurimit pas hapjes së ofertave duhet të anulohet për një nga arsyet e mëposhtme:
a. asnjë tender nuk është paraqitur brenda afatit të specifikuar;
b. asnjëri prej tenderëve të pranuar nuk është i përgjegjshëm;
c. numri i OE të përgjegjshëm për kontratë publike kornizë me më shumë se një OE është më pak se 3(tre);
d. nuk ka kërkesa për të marrë pjesë, në procedurat e kufizuara ose konkurruese me negociata, që janë paraqitur brenda afatit të specifikuar; e. numri i kandidatëve të kualifikuar në procedurën e kufizuar/ konkurruese me negociata është më pak se 3;
f. nuk ka projekte që janë paraqitur brenda afatit të specifikuar;
g. asnjë nga projektet e pranuara në konkursin e projektimit nuk janë të përgjegjshëm;
h. nëse urdhërohet nga Organi Shqyrtues i Prokurimit;
i. një shkelje e ligjit ka ndodhur ose do të ndodhë dhe nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një ndryshimi;
j. nëse AK gjatë përgatitjes dhe udhëheqjes se procedurës ka përdorur gabimisht opsionin për procedurën përkatëse dhe i cili gabim me verifikim të KRPP-se është i pariparueshëm; ose
k. nëse është paraqitur një gabim teknik në platformën e prokurimit elektronik nga ndonjë situatë e paparashikuar dhe jashtë kontrollit të AK dhe i cili gabim është i pariparueshëm sipas verifikimit dhe konstatimit nga KRPP.
Asnjë nga situatat që parashihen në këtë nen nuk ka ndodhur dhe AK nuk është dashur të anulojë procedurën në këtë fazë.
Çdo arsyetim tjetër në këtë fazë, na bën të dyshojmë që AK ka përgatitur DT dhe ST për OE të rekomanduar me datë: 30.10.2026 dhe ka vepruar në kundërshtim me nenin 6 dhe 7 të LPP-së.

Kërkojmë nga OSHP të aprovojë ankesën tonë dhe të detyrojë AK që Vlerësimin e tenderit ta bëjë në përputhje me kërkesat e FDT dhe ST të publikuara dhe në harmoni me nenin 59 të LPP-së.

Ne vendimin e OSHP-së me numër OSHP: 2026/0216, në një procedurë tjetër por për të njëjtin pretendim që ne si OE jemi ankuar, citoj:
"*Eksperti shqyrtues sqaron që AK ka anuluar këtë procedurë të prokurimit me arsyetimin se është konstatuar një gabim në paramasë dhe parallogari i cili ka ndikuar në kërkesat për ofertim të çmimeve dhe se ky gabim cenon parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës. Ky anulim është bërë nga AK, pas pranimit të kërkesës për rishqyrtim të bërë nga OE ankues, përmes të cilës është pretenduar se në një pjesë të përshkrimit të çmimeve të OE i rekomanduar janë bërë gabime duke mos u plotësuar disa çmime në pjesën D të përshkrimit të çmimeve, pozicionin 12 të listës së OE i rekomanduar.*
Anulimi i kësaj procedure me arsyetimin se janë lëshuar gabime në paramasë dhe parallogari, pas hapjes së ofertave konsiderojmë që nuk është bërë në përputhje me nenin 62 të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP), për arsye se nëse operatorët e interesuar për të ofertuar kanë parë gabime potenciale të njëjtit kanë pasur mundësi që të kërkojnë sqarime shtesë nga AK sipas nenit 53 të LPP-së apo që të dorëzojnë kërkesë për rishqyrtim dhe ankesë sipas nenit 108/A, pika 3.1 e LPP-së. Sipas sistemit e-prokurimi nuk është parë se ndonjë operator ekonomik ka shprehur ndonjë ankesë për gabime në paramasë apo diçka të ngjashme dhe në momentin që ata kanë vendosur të ofertojnë është dashur që të gjitha pozicionet të plotësohen sipas shabllonit të përgatitur dhe publikuar nga autoriteti kontraktues.
Pra, sipas mendimit të ekspertit shqyrtues, anulimi i kësaj procedure në këtë fazë nuk përkon me nenin 62 të ligjit dhe as me nenin 43 të Rregullores për Prokurimin Publik, për arsye se shihet se asnjëri operator nuk ka pasur ankesa në lidhje me vendosjen e çmimeve të kërkuara nga AK dhe për më tepër AK nuk ka arsyetuar se cila shkelje e ligjit ka ndodhur e cila nuk mund të rregullohet apo parandalohet. Në rastin konkret AK ka dhënë vetëm një arsyetim të përgjithshëm të gabimeve duke mos potencuar saktësisht se cili është problemi kryesor. Tutje, konsiderojmë që AK në këtë pikë duhet të trajtoj barabartë të gjithë operatorët ofertues sipas nenit 7 të LPP-së edhe në rastin që pretendohet se sipas tyre është lëshuar ndonjë gabim në paramasë dhe parallogari të përgatitur nga AK."

Përfundim
Duke u bazuar në të gjitha faktet që u cekën më lartë kërkojmë nga AK që ta rishqyrtoni edhe një herë vendimin sepse është në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-042 PËR PROKURIMIN PUBLIK TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, I ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 (Versioni i Konsoliduar), konkretisht e:
Ligji Nr. 04/L-042 PËR PROKURIMIN PUBLIK TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, I ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 (Versioni i Konsoliduar)
Neni 6 - Ekonomiciteti dhe Efikasiteti
Neni 7 - Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
Nenin 62 - Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit

RREGULLORE NR.002/2024 PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORES NR. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK (Versioni i Konsoliduar)
Neni 40 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
Neni 43 - Ndërprerja e procedurave të prokurimit

UDHËZUES Nr. 002/2024, PËR PLOTËSIM NDRYSHIMIN E UDHËZUESIT Nr. 001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK
10. Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve
Pretendimi ynë është i bazuar në dëshmi dhe fakte të cilat lehtësisht mund të verifikohen, dëshmi të cilat i potencuam edhe më lartë, prandaj kërkojmë që NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES B58 i këtij tenderi të anulohet dhe të aprovohet kërkesa jonë për rivlerësim të tenderit, dhe pas një vlerësimi korrekt të shpallemi NE si fitues i tenderit në fjalë.
Duke u bazuar në faktet që u përmenden me lartë, kërkojmë nga ju që të shqyrtoni Kërkesën tonë për Rishqyrtim në mënyrë meritore dhe të nxjerrni këtë:
VENDIM
APROVOHET, si e bazuar Kërkesa për Rishqyrtim të Vendimit e OE Gentian Sakaj B.I., te anulohet "Njoftim mbi vendimin e autoriteti kontraktues" për këtë aktivitet të prokurimit dhe njëkohësisht kërkojmë që të ktheni tenderin në rishqyrtimin dhe rivlerësimin e këtij aktiviteti të prokurimit sipas dispozitave të LPP-së dhe duke u bazuar në kërkesat e FDTsë dhe të njoftimit për kontratë, duke na rekomanduar kompaninë tonë fituese pasi që supozojmë që jemi të kompletuar për këtë projekt.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Konsiderojmë që kemi bërë shpenzime materiale për përgatitjen e ofertës, për kërkesën për rishqyrtim, si dhe dëme tjera që mund të ndodhin në përgatitjen e ankesës pranë OSHP-së

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
b) *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
e) *bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,*
f) *Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*

g) *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*